

REZOLUTË

PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE ME BASHKIMIN EUROPIAN

Në përmbushje të misionit të Kuvendit, si përfaqësues të zgjedhur, të qytetarëve shqiptarë;

Në respekt të plotë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe synimit madhor të shqiptarëve për të qenë pjesë me të drejta të plota në familjen europiane;

Të vendosur për të zbatuar detyrimet që rrjedhin gjatë procesit të integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian;

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, i mbledhur sot, në datën 11.3.2010,

- **Me bindjen** se lëvizja e lirë e njerëzve çon në forcimin e lidhjeve njerëzore, ekonomike, kulturore dhe shkencore midis Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, duke u bërë kështu mbështetje për një Shqipëri që përparon nëpërmjet forcimit të demokracisë, ekonomisë së tregut dhe vlerave të shtetit të së drejtës, në dobi të qytetarëve;

- **Duke çmuar** dialogun me BE-në për liberalizimin e vizave, si mbështetje për plotësimin e detyrimeve dhe si një proces të bazuar në përmbushjen e kushteve të vendosura në Udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave;

- **Duke vlerësuar** angazhimin e Parlamentit dhe Këshillit të BE-së për liberalizimin e vizave me Shqipërinë sa më shpejt që të jetë e mundur, të shprehur në deklaratën e përbashkët të Këshillit dhe Parlamentit më 12 nëntor 2009;

- **I bindur** se liberalizimi i regjimit të vizave është pjesë e procesit të integritetit europian të Shqipërisë;

- **Duke konsideruar** se ky proces është në dobi të zhvillimit dhe stabilitetit të rajonit të Ballkanit Perëndimor;

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

- Konfirmon mbështetjen e të gjitha forcave politike të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për liberalizimin e shpejtë të vizave dhe mbështet me vendosmëri lëvizjen e lirë të shtetasve shqiptarë në hapësirën *Schengen*;

- Çmon arritjet e institucioneve shtetërore të Republikës së Shqipërisë në përmbushjen e detyrimeve të procesit të liberalizimit të vizave dhe mbështet përpjekjet e tyre për të konsoliduar më tej përparimin e dukshën, të vlerësuar tashmë edhe nga institucionet e BE-së;

- Vlerëson Rezolutën e datës 26 nëntor 2009 të Parlamentit Europian, në të cilën shprehet mbështetja që liberalizimi i vizave të mund të realizohet deri në korrik 2010;

- Shpreh njëherazi kënaqësinë për përfundimin e misionëve të ekspertëve të Komisionit Europian dhe besimin se Komisioni do të realizojë përgatitjen e raportit vlerësues në fillim të pranverës 2010 për t'i hapur rrugën marrjes së vendimit nga Këshilli për liberalizimin e vizave nga Këshilli i BE-së para muajit korrik 2010;

- Mirëpret që Parlamenti Europian, vendet anëtare dhe Komisioni Europian të marrin në konsideratë përmbushjen e detyrimeve të Udhërrëfyesit nga Shqipëria, si dhe konsensusin që ekziston mes të gjitha forcave politike të Republikës së Shqipërisë për të arritur udhëtimin pa viza të qytetarëve shqiptarë në hapësirën *Schengen*, si pjesë e aspiratës së tyre për lirinë e lëvizjes.

11 mars 2010